**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI I TIRANËS**

**Komisioni Institucional i Zgjedhjeve**

# VENDIM Nr. 14

Tiranë, më 05.07.2020

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*; të "*Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në UT*"; miratuar me Vendim nr. 5, datë 10.02.2020, Kreu IV, neni 17, neni 18, 22, neni 23, të Urdhrit nr. 175, datë 30.06.2020 të MASR-së " Për zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë" në zbatim të urdhrave të Ministrit të Arsimit të Sportit dhe të Rinisë Nr.8, datë 14.01.2020 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar dhe nr.108, datë 08.05.2020 "Për shtyrjen e datës së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia Covid−19", Vendimit nr.13, datë 01.07.2020 i KIZ-i i UT-ës, *KIZ në mbledhjen e tij datës 05.07.2020*:

## VENDOSI:

1. **Të shpallë mbylljen e procesit të regjistrimit** të kandidatëve për "Rektor" dhe "Anëtar i Senatit Akademik" të UT−së sipas vendimit nr.13 të KIZ më datë 01.07.2020.

2. **Të miratojë** dhe **të shpallë** listat e kandidatëve të regjistruar për "Rektor" për Universitetin e Tiranës. Lista i bashkëngjitet këtij Vendimi të KIZ−it.
3. **Të miratojë** listën për "Anëtar Senati" për Universitetin e Tiranës përfaqësues nga personeli akademik. Lista i bashkëngjitet këtij Vendimi.
4. **Të nxjerrë listën** paraprake të aplikantëve të regjistruar, kandidat për "Anëtar i Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve". Lista i bashkëngjitet këtij Vendimi.
5. **Të nisë procesin e verifikimit në bashkëpunim me sekretaritë mësimore** të njësive kryesore të UT-s për aplikantët e ditës së fundit, kandidat për "Anëtar i Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve", sipas Kreu IV, neni 18, pika 3, neni 22, pika 2, neni 23, pika 2 d, pika 3 të Regullores. *Afati i përcaktuar i*

*verifikimit dhe i dërgimit në lidhje me këtë informacion të kërkuar nga KIZ është deri në datë 06.07.2020, ora 16.00.* Në përfundim të këtij procesi KIZ shpall listën e kandidatëve për "Anëtar i Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve" për Universitetin e Tiranës.

6. Ky Vendim dhe listat u përcillen *për t`u shpallur në faqen zyrtare elektronike dhe në "Këndin zgjedhor" të UT-së dhe në të gjitha njësitë kryesore të UT-së.*
7. **Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të UT-së**

1. Majlinda KETA
2. Bernard DOSTI
3. Oriona MUÇOLLARI
4. Ardian DOKA
5. Eglantina GISHTI
6. Eno LUSHKA